

MBI VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE TË ERRU-së

PËR VITIN 2024

Në këtë raportim do të analizohen treguesit financiar të vitit 2024 ne periudha 4-mujore lidhur me argumentet e mëposhtme:

- 1. Mbi veprimtarinë e DSHM-së**
- 2. Të ardhurat**
 - 2.1. Pagesat rregullatore
 - 2.2. Pagesat për licencime
- 3. Shpenzimet**
- 4. Investime**

1. MBI VEPRIMTARINË E DSHM-SË

Në përmbushje të detyrave funksionale, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse gjatë vitit 2024 ka punuar për:

- o mbështetjen e plotë logjistike dhe financiare të strukturave organizative të Entit, për ushtrimin normal të aktiviteteve dhe veprimtarisë së tij funksionale dhe ngjarjeve të veçanta;
 - o monitorimin e vazhdueshëm të shpenzimeve buxhetore dhe materiale;
 - o miradministrimin e aktiveve e vlerave materiale të njësisë;
 - o monitorimin detyrimeve kontraktuale të operatorëve lidhur me detyrimet e pagesave rregullatore dhe të detyrimeve të prapambetura;
 - o trajtimin financiar të punonjësve në mbështetje të akteve ligjore dhe detyrimeve që rrjedhin prej tyre dhe përmbushjen e të drejtave e detyrimeve punëdhënëse e punëmarrës;
 - o ndjekjen e procedurave të rekrutimit të nëpunësve të rinj për vendet vakante në strukturë.
- Në vitin 2024 në bazë të VKM 33/2022 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së entit rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (ERRU)” ka pasur 3 procedura për plotësimin e strukturës. Në përfundimin të tyre kanë filluar marrëdhënien e punës nëpunës të rinj, Specialist i rrjeteve inxhinierike të KUN dhe ITUN në Drejtorinë Tekniko-Ekonomike, një Specialist IT

në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse dhe një Specialist Ligjor në Drejtorinë Juridike dhe Konsumatorit.

- o përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin fiskal 2023 dhe ndjekjen e auditimit të brendshëm;
- o prezantimin e raportit financiar 2023 si pjesë takuese e botimit të veprimtarisë së ERRU-së;
- o prezantimin e raportit financiar çdo 4 muaj për vitin 2024;
- o hartimi, prezantimi dhe ndjekja e procedurës për miratim i Plan buxhetit 2025.

2. TË ARDHURAT

2.1 Pagesat Rregullatore

Pagesat rregullatore të operatorëve që operojnë në sektorin UK dhe pagesat për liçensimin e tyre përbëjnë burimin e vetëm të financimit në ERRU, sikurse përcaktohet në ligjin 8102 datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”.

Detyrimet e pagesave rregullatore, përlllogariten nga vlerat e përcaktuara në kontratat e nënshkruara mes Operatorëve UK dhe Entit.

Në bazë të pikës 3 të VKM 302 dt, 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” gjatë vitit 2023 dhe 4-mujorit të parë të vitit 2024 është krijuar (pas nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit) 1 (një) subjekt me kompetenca të përbashkëta (SKP) që i shtohet 13 (trembëdhjetë) SKP-ve të krijuara në 2023.

Sipas përkufizimit SKP-të janë shoqëri të reja aksionere të cilave u janë transferuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionere ekzistuese të UK. Ka ngelur pa nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit një njësi e vetëqeverisjes vendore ajo e qarkut Tiranë që përfshin Sh.a.u.k Tirane, Sh.a.u.k Vorë dhe Sh.a.u.k Kamëz.

Sipas pikës 11 të VKM 302 dt. 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” SKP-të e krijuara respektojnë dhe zbatojnë kontratat e shërbimeve të lidhura para krijimit të tyre dhe detyrimet kontraktore që burojnë nga marrëveshjet e lidhura. Në bazë të kësaj pike ndërmjet të gjitha shoqërive SKP të krijuara dhe ERRU-së janë nënshkruar akt-marrëveshje ku është njohur detyrimi i mbartur. Gjatë vitit 2023 janë nënshkruar 12 akt marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe koherente me 6 prej të cilave me afat maksimal likuidimi deri në përfundim të muajit prill 2024, proces ky i pambyllur gjatë këtij afati për disa shoqëri. Gjatë katër muajorit të parë të vitit 2024 është nënshkruar akt marrëveshja me SKP Shkodër. Më poshtë paraqitet tabela e detajuar me të dhënat mbi akt marrëveshjet me SKP dhe detyrimet koherente në baze të kontratave të reja të lidhura gjatë vitit 2024 sipas Vendimit të KKRR nr. nr.38 date 05.10.2023:

Tabela nr.1 Detyrimi dhe likuidimi i pagesave rregullatore të SKP-ve deri më 31.12.2024

në lekë

NR	Shoqëri me kompetenca të përbashkëta (SKP)	Detyrim i mbartur 31.12.2023	Detyrim vjetor Pag. Rregull. 2024	Likuidime për detyrime të mbartura	Likuidime për detyrime vjetore	Total Likuidime 2024	Mbetej 31.12.2024	Të dhëna akt-marrëveshje	Shënime
1	Shoqëria Rajonale UK Shkodër sha Sh.a.u Malesi e Madhe Sh.a.u.k Shkoder Sh.a.u.k Vau i Dejes Nd. UK Puke Sh.a.u Shkoder-Fshat Sh.a.u.k Fushe Arrez	2,500,600	2,779,409	2,500,600	2,780,785	5,281,385	(1,376)	Akt marrëveshje nr. 16 dt. 10.01.2024 për tu shlyer: - Detyrimi i mbartur me 24 kështe (23 x 100000 + 150600) - Aneks kontratë nr. 282 dt. 12.08.2024 per tu shlyer dy keste 2409 - 2412	ok. shlyer plotesisht para afatit ok. shlyer plotesisht
2	Shoqëria Rajonale UK Kukës sha Sh.a.u Kukës Sh.a.u Tropoje Sh.a.u Has	1,140,500	809,936	205,000	-	205,000	1,745,436	Akt marrëveshje nr. 57 dt. 06.02.23 për tu shlyer: - Detyrimi i mbartur para 2023 me 16 kështe (15 x 41000+40500) - Detyrim i mbartur 2023 ne vliere 608 000 - Aneks Akt-Marreveshje nr.340 datë 20.09.2024 'pag.rregullatore 2024 per tu shlyer dy keste 2409 - 2412 Akt marrëveshje nr. 63 dt. 08.02.23 për tu shlyer: - Detyrimi mbartur me 16 kështe (15 x 146800+146165) - Kontrate nr.141 Prot. Date 18.04.2024 per tu shlyer me dy keste 2405-2409	nuk është respektuar paguar pjeserisht nuk është shlyer ok. paguar plotesisht ne 4-majorin e II-te ok. shlyer plotesisht
3	Shoqëria Rajonale UK Lezhë sha Sh.a.u.k Lezhe Sh.a.u.k Mirdite(Rreshen) Sh.a.u Kurbin Laç	586,565	2,731,000	586,565	2,731,000	3,317,565	-	Akt marrëveshje nr. 35 Prot. Date 25.01.23 - Gjithe detyrimi me 16 kështe (2.000.000 +15 x 1.700.000) - Kontrate nr.212 Prot. Date 13.06.2024 per tu shlyer me dy keste 2406-2409 - Akt marrëveshje nr.61 Prot. Date 13.02.23 - Gjithe detyrimi me 16 kështe (436.688 +15 x 436.600) - Kontrate nr.180 Prot. Date 24.05.2024 per tu shlyer me 2 keste 2406-2409 -Aneks Akt-Marreveshje nr.336/3 datë 25.11.2024 pag.rregullatore 2024 per tu shlyer dy keste 2409 - 2412	ok. paguar plotesisht ne 4-majorin e II ok. shlyer plotesisht ok. paguar plotesisht ne 4-majorin e I pjeserisht kesti I dyte nuk është shlyer
4	Shoqëria Rajonale UK Dibrë sha Sh.a.u Bulqize Sh.a.u Mat(Burrel) Sh.a.u k Peshkopit(DIBER) Sh.a.u Klos	768,432	1,233,385	768,432	-	768,432	1,233,385	Akt marrëveshje nr. 53 dt. 02.02.23 për tu shlyer: - Detyrimi mbartur me 16 kështe(15 x 64000 +64 682) Aneks Akt-Marreveshje nr.291/1 datë 16.09.2024 pag.rregullatore 2024 per tu shlyer dy keste 2409 - 2412	ok. paguar plotesisht ne 4-majorin e II-te nuk ka shlyer asnje kest
5	Shoqëria Rajonale UK Durrës sha Sh.a.u.k Rrugozhine Sh.a.u.k Kruje Sh.a.u.k Dures Sh.a.u.k Kavaje Sh.a.u.k Shijak	6,063,558	13,433,000	6,063,558	13,433,000	19,496,558	-	- Akt marrëveshje nr.35 Prot. Date 25.01.23 - Gjithe detyrimi me 16 kështe (2.000.000 +15 x 1.700.000) - Kontrate nr.212 Prot. Date 13.06.2024 per tu shlyer me dy keste 2406-2409 - Akt marrëveshje nr.61 Prot. Date 13.02.23 - Gjithe detyrimi me 16 kështe (436.688 +15 x 436.600) - Kontrate nr.180 Prot. Date 24.05.2024 per tu shlyer me 2 keste 2406-2409 -Aneks Akt-Marreveshje nr.336/3 datë 25.11.2024 pag.rregullatore 2024 per tu shlyer dy keste 2409 - 2412	ok. paguar plotesisht ne 4-majorin e II ok. shlyer plotesisht
6	Shoqëria Rajonale UK Fier sha Sh.a.u.k Fier Sh.a.u.k Mallakastrë(Ballsh) Sh.a.u Patos Sh.a.u.k Roskovec	4,802,688	5,678,000	4,802,688	3,839,000	8,641,688	1,839,000	- Akt marrëveshje nr. 73 dt. 13.02.23 për tu shlyer: - Detyrimi mbartur me 12 kështe(11 x 253.600 -Aneks Akt-Marreveshje nr.388 datë 21.10.2024 pag.rregullatore 2024 per tu shlyer dy keste 2410 - 2411	ok. paguar plotesisht ne 4-majorin e I pjeserisht kesti I dyte nuk është shlyer
7	Shoqëria Rajonale UK Lushnjë sha Sh.a.u.k Lushnje Sh.a.u Lushnje Fshat Sh.a.u Divjake	-	1,942,547	-	-	-	1,942,547	-Aneks akt marrëveshje nr.278 date 06.08.2024 per tu shlyer me 2 keste 2409-2412	ok. paguar plotesisht ne 4-majorin e I paguar pjeserisht kesti I pare
8	Shoqëria Rajonale UK Elbasan sha Sh.a.u Gramsh Sh.a.u.k Librazhd-Perrenjas Sh.a.u.k Peqin Sh.a.u.k Elbasan Sh.a.u Elbasan Fshat Sh.a.u.Belsh Sh.a.u.k Cerrik	3,964,765	4,301,886	3,964,765	2,000,000	5,964,765	2,301,886	Akt marrëveshje nr. 73 dt. 13.02.23 për tu shlyer: - Detyrimi mbartur me 12 kështe(11 x 253.600 -Aneks Akt-Marreveshje nr.388 datë 21.10.2024 pag.rregullatore 2024 per tu shlyer dy keste 2410 - 2411	ok. paguar plotesisht ne 4-majorin e I paguar pjeserisht kesti I pare
9	Shoqëria Rajonale UK Berat sha Sh.a.u Polican Sh.a.u Skrapar Sh.a.u Ura vajguore (Dimal) Sh.a.u.k Berat - Kuçove	-	2,580,364	-	2,580,364	2,580,364	-	- Aneks akt marrëveshje nr.278 date 06.08.2024 per tu shlyer me 2 keste 2409-2412	ok. paguar plotesisht
10	Shoqëria Rajonale UK Korçë sha Sh.a.u.k Korçë Sh.a.u.k Kolonje (Erseke) Sh.a.u Maliq Sh.a.u Bilisht (Devoll) Sh.a.u Pustec	-	3,556,840	-	-	-	3,556,840	- Aneks akt marrëveshje nr.279 date 06.08.2024 pagese rregullatore 2024 per tu shlyer me 2 keste 2409-2412	nuk ka paguar asnje kest
11	Shoqëria Rajonale UK Pogradec sha Sh.a.u.k Librazhd-Perrenjas Sh.a.u.k Pogradec	-	1,607,509	-	1,607,509	1,607,509	-	- Kontrate nr.276 Prot. Date 06.08.2024 pagese rregullatore 2024 per tu shlyer me 2 keste 2409-2412 Akt marrëveshje nr. 70 dt. 13.02.23 për tu shlyer: - Detyrimi mbartur me 16 kështe (15x 138.500 +139.550) - Aneks akt marrëveshje nr.262/1 date 17.07.2024 pag.rregullatore 2024 per tu shlyer me 2 keste 2409-2412	ok. paguar plotesisht ne 4-majorin e II paguar pjeserisht kesti I pare
12	Shoqëria Rajonale UK Gjirokastrë sha Sh.a.u Pemet Sh.a.u k Tepelene Sh.a.u.k Kelyce Sh.a.u.k Libohove Sh.a.u Dropull Sh.a.u Memalaj	2,084,715	1,707,461	2,084,715	791,386	2,876,101	916,075	- Detyrim i mbartur uk Selenice - Kontrate nr.462 Prot. Date 28.12.2023 per tu shlyer me 2 keste 2404-2410	-nuk është shlyer paguar vetem kesti pare
13	Shoqëria Rajonale UK Vlorë sha Sh.a.u Vlore Sh.a.u Selenice Sh.a.u.k Himare	481,500	4,895,000	-	2,447,500	2,447,500	2,929,000	- Aneks akt marrëveshje nr.367 date 10.10.2024 pag.rregullatore 2024 per tu shlyer me 2 keste 2409-2412	ok. paguar plotesisht
14	Shoqëria Rajonale UK Sarandë sha Sh.a.u.k Sarande Sh.a.u Delvine Sh.a.u Konispol Sh.a.u Finiq	-	2,246,744	-	2,246,744	2,246,744	-		
TOTALI		22,393,323	49,503,081	20,976,323	34,457,288	55,433,611	16,462,793		

Nga shoqëritë, të cilat duhet të shlyejnë detyrimin sipas aktmarrëveshjes në fund të katër mujorit të parë të vitit 2024 kanë përmbushur detyrimet kontraktuale në kohë SKP Durrës dhe SKP Fier. Kanë likuiduar plotësisht, me vonesë në katër mujorin e dytë, gjithashtu detyrimin sipas akt marrëveshjes SKP Lezhë, SKP Dibrë dhe SKP Gjirokastrë.

SKP Elbasan sipas akt marrëveshjes nr. 73 date 13.02.2023 duhej të shlyente gjithë detyrimin me kështe brenda vitit 2023 por ka likuiduar me vonese gjithë vlerën në 4-mujorin e parë 2024.

Siç shihet ne tabelë ka shlyer pjesërisht SKP Kukës.

SKP Vlorë pas krijimit nuk ka nënshkruar ende akt marrëveshje dhe ka një detyrim të mbartur të shoqërisë UK Selenicë në vlerën 481 500 lekë.

Ka nënshkruar akt marrëveshjen në datën 10.01.2024 SKP Shkodër për shlyerjen brenda 2 vjetëve të detyrimit të mbartur deri me 31.12.2023 dhe ka likuiduar para afatit në katër mujorin e dytë gjithë detyrimin.

Në katër mujorin e parë ka dy kontrata për pagesë rregullatore 2024 me SKP Lezhë nr.141 datë 18.04.2024 dhe SKP Vlorë sipas kontratës nr.462 date 28.12.2023.

Në katër mujorin e dytë janë nënshkruar 7 kontrata të reja sipas vendimit të KKRR nr. 38 datë 05.10.2023 për Pagesën Rregullatore të vitit 2024 me shoqëritë SKP Shkodër, SKP Durrës, SKP Fier, SKP Berat, SKP Korçë, SKP Pogradec, SKP Gjirokastrë.

Në katër mujorin e tretë janë nënshkruar 5 kontrata të reja sipas vendimit të KKRR nr. 38 datë 05.10.2023 për Pagesën Rregullatore të vitit 2024 me shoqëritë SKP Kukës, SKP Dibër, SKP Lushnjë, SKP Elbasan dhe SKP Sarandë.

Siç u përmend më sipër vazhdon një njësi e vetëqeverisjes vendore ajo e Tiranës e cila nuk është krijuar SKP.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur kjo shoqëri aksionere UK e grupuar sipas ndarjes territoriale dhe është analizuar detyrimi.

Në katër mujorin e tretë Sh.a.u.k Tiranë ka nënshkruar Anësi Kontratën nr. 6 datë 12.09.2024 për pagesë rregullatore 2024 me kusht likuidimi me dy këste të barabarta në periudhat 2409-2412. Shoqëria UKT ka likuiduar gjithë detyrimin e mbartur nga viti 2023 dhe pjesërisht këstin e parë të pagesës rregullatore për vitin 2024.

Në katër mujorin e dytë është nënshkruar Aneksi Kontrata nr.268/1 datë 17.07.2024 për detyrim vjetor 2024 me Sh.a.u.k Vorë me afat për shlyerjen e kështit të parë në shtator e cila nuk ka respektuar afatet për likuidim. Detyrime të mbartura nuk ka.

Shoqëria UK Kamëz nuk ka tarifa dhe nuk ka kontrata rregullatore.

Tabela nr.2 Detyrimi dhe likuidimi i pagesave rregullatore të UK (jo SKP) deri më 31.12.2024

në lekë

NR	Emërtimi i subjektit	Detyrim i mbartur 31.12.2023	Detyrim vjetor Pag. Rregull. 2024	Likuidime për detyrime të mbartura	Likuidime për detyrime vjetore	Total Likuidime 2024	Mbetje 31.12.2024	Të dhëna kontrata	Shënime
1	Shoqëria Rajonale UK Tiranë sh.a								
1.1	Sh.a.u.k Tiranë	3,200,000	31,052,537	3,200,000	11,800,000	15,000,000	19,252,537	- Aneksi Kontrata Nr.6 Prot. Datë 12.09.2024 pag.rregullatore 2024 për tu paguar 2409-2412	paguar pjesërisht kasti I pare
1.2	Sh.a.u.k Vorë	-	604,722	-	-	-	604,722	- Aneksi kontratë nr. 268/1 dt. 17.07.2024 pag.rregullatore 2024 për tu paguar 2409-2412	asnjë pagese
1.3	Sh.a.u.k Kamëz	-	-	-	-	-	-	Nuk ka tarifa	
	TOTALI	3,200,000	31,657,259	3,200,000	11,800,000	15,000,000	19,857,259		

Në përfundim të vitit shoqëritë që nuk kanë respektuar afatet sipas kontratave apo aneksi akt marrëveshjeve, për shlyerjen e detyrimit të prapambetur apo detyrimet kontraktuale vjetore, janë kontaktuar në formë shkresore për përmblidhjen e detyrimit shoqëritë që kanë vonesa.

Detyrimet dhe arkëtimet e periudhës raportuese jepen në mënyrë përmblidhëse në tabelën e mëposhtme nr.3 Për pagesat e licencimit e ardhura e realizuar përllëgaritet si detyrim i konstatuar.

Tabela nr.3 Detyrime dhe likuiditete më 31.12.2024

në lekë

Përshkrim	Gjendje detyrimesh më 31.12.2023	Detyrime kontraktuale 2024	Totali i detyrimeve 2024	Likuidime 4-mujori i I	Likuidime 4-mujori i II	Likuidime 4-mujori i III	Gjendje detyrimesh më 31.12.2024
Pagesa Rregullatore	25,593,323	81,160,340	106,753,663	18,368,592	22,201,101	29,863,918	36,320,051
Pagesa Licencimi	-	690,000	690,000	120,000	40,000	530,000	-

Detyrimi i Pagesës Rregullatore për vitin 2024 në vlerën totale sipas kontratave të nënshkruara është 81 160 340. Në këtë vlerë është përfshirë detyrimi vjetor sipas kontratave me të dhëna në tabelën nr. 1 dhe nr.2

Arkëtimet për detyrimet e pagesës rregullatore të vitit 2024 në datën e raportimit janë në vlerën 46 257 288 lekë ose 57% e detyrimit total (detajuar për çdo operator në tab.1 dhe tab.2) duke e çuar detyrimin për t'u paguar të pagesës rregullatore vjetore 2024 në vlerën 34 903 052 Lekë.

Tabela nr.4

në lekë

Pagesa Rregullatore vjetore ▾	Likuidime ▾	Mbetje ▾
81,160,340	46,257,288	34,903,052

Detyrimet e mbartura për pagesë rregullatore të shoqërive Ujësjiellës Kanalizime më 31.12.2023 janë në vlerë totale 25 593 323 lekë. Arkëtimet vetëm për detyrimet e prapambetura në periudhën raportuese janë 24 176 323 lekë ose 94% e detyrimit total (detajuar për çdo operator në tab.1 dhe tab.2) të cilat e ulin këtë detyrim në vlerën 1 417 000 lekë. Siç shihet në tabelë ky detyrim u përket vetëm dy shoqërive rajonale SKP Kukës dhe SKP Vlorë.

Tabela nr.5

në lekë

Pagesa Rregullatore të mbartura	Likuidime	Mbetje
25,593,323	24,176,323	1,417,000

Për sa me sipër në mënyrë përmbledhëse vlera totale e likuidimeve deri më 31.12.2024 është 36 320 052 lekë e përberë nga shlyerje të detyrimeve të prapambetura dhe në shlyerje të detyrimit për vitin 2024. Detajimi i arkëtimeve më poshtë në bazë mujore.

Tabela nr. 6 Arkëtime totale mujore 2024

në lekë

NR	SKP	Paguar tot.	PAGUAR NE MUAJT											
		2024	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1	Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a	5,281,385				1,400,000	100,000			2,070,254		1,711,131		
2	Shoqëria Rajonale UK Kukës sh.a	205,000										205,000		
3	Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a	3,317,565		146,800	146,800	146,800	146,165			1,365,500			1,365,500	
4	Shoqëria Rajonale UK Dibër sh.a	3,768,432	319,750	192,000						256,682		3,000,000		
5	Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a	16,496,558	1,700,000	4,363,558			2,000,000	1,700,000		2,000,000			3,000,000	1,733,000
6	Shoqëria Rajonale UK Tiranë sh.a													
6.1	Sh.a.u.k Tirane	15,000,000					5,000,000					5,000,000		5,000,000
6.2	Sh.a.u.k Vore	-												
6.3	Sh.a.u.k Kamez	-												
7	Shoqëria Rajonale UK Fier sh.a	8,641,688	2,000,000		2,802,688					2,839,000			1,000,000	
8	Shoqëria Rajonale UK Lushnjë sh.a	-												
9	Shoqëria Rajonale UK Elbasan sh.a	5,964,765				3,964,765						2,000,000		
10	Shoqëria Rajonale UK Berat sh.a	2,580,364									2,580,364			
11	Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a	-												
12	Shoqëria Rajonale UK Pogradec sh.a	1,607,509				585,330					585,330			436,849
13	Shoqëria Rajonale UK Gjirokastr sh.	2,876,101		600,101				2,276,000						
14	Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a	2,447,500								2,447,500				
15	Shoqëria Rajonale UK Sarandë sh.a	2,246,744										1,123,372		1,123,372
	TOTALI	70,433,611	4,019,750	5,302,459	2,949,488	6,096,895	7,246,165	3,976,000	-	10,978,936	3,165,694	13,039,503	5,365,500	8,293,221

Ditari i pagesave rregullatore për çdo operator, gjendet në **Aneks nr. I** “Evidencë e gjendjes së pagesave rregullatore 2024”.

2.2 Të ardhura nga Licencimet

Për pagesat e licencimit e ardhura e realizuar përlllogaritet si detyrim i konstatuar. Arkëtimi total nga licencimet në katër mujin e parë të vitit 2024 është 690 000 lekë dhe është detajuar sipas tabelës se mëposhtme:

Tabela nr.7 Likuidime për licencime deri me 31.12.2024

				në lekë
1	Liçencim Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a	4-mujori I		40,000
2	Liçencim Shoqëria Rajonale UK Durrës sh.a	4-mujori I		80,000
3	Tarife per ndryshim Drejtues Ligjor SKP Durres sh.a	4-mujori II		40,000
4	Liçencim Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a	4-mujori III		300,000
5	Tarife per ndryshim Drejtues Ligjor SKP Kukës sh.a	4-mujori III		40,000
6	Liçencim UK Vorë	4-mujori III		40,000
7	Liçencim Shoqëria Rajonale UK Korcë sh.a	4-mujori III		150,000
TOTALI				690,000

3. SHPENZIMET

Plani i shpenzimeve operative vjetore të ERRU për vitin 2024, është miratuar me VKM nr. 702, datë 06.12.2023, "Për miratimin e planit të shpenzimeve operative, për vitin 2024, për Entin Rregullator të Sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura".

Në total vlera e plan buxhetit për shpenzimet është 71 217 100 lekë.

Detajimi i planit të shpenzimeve operative, kompetencë e KKRR, në përputhje me kuotat e miratuara nga KM, u detajua me Vendimin e Komisionit nr. 1, datë 10.01.2024 dhe është ndryshuar në vazhdimësi në bazë të nevojave të institucionit me Vendim nr.48 date 02.12.2024.

Plani vjetor i shpenzimeve operative në total në shumën 71 217 100 lekë, është i ndarë në 4 klasa Paga, Sigurime shoqërore e shëndetësore, Shërbime e furniturë dhe Investime.


Në përputhje me procedurat e prokurimit të përcaktuara me ligjin nr. 9643, "Për prokurimet publik" dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Komisioni i blerjeve ka realizuar blerjet e mallrave apo shërbimeve të parashikuara në regjistrin vjetor të prokurimeve.

Realizimi planit të shpenzimeve për këtë periudhë, në raport me planin vjetor të miratuar, detajuar sipas zërave kryesore paraqitet në **Tabelën nr.8** dhe më poshtë në mënyrë grafike.

Tabela nr.8 Realizimi i planit të shpenzimeve deri me 31.12.2024

në lekë

Nr.	Emërtimi i zërave të shpenzimeve	Plani Vjetor	Realizmi Janar-Prill 2024	Realizimi Maj-Gusht 2024	Realizimi Shtator-Dhjetor 2024	Realizimi Total	%	Mbetje	%
1	Fondi i pagave gjithësej	47,252,500	13,326,127	12,994,806	14,877,132	41,198,065	87%	6,054,435	13%
2	Sigurime Shoqërore	7,507,600	2,167,957	2,147,611	2,200,793	6,516,361	87%	991,239	13%
3	Shërbime Fumiture	13,957,000	2,872,117	2,718,066	5,292,087	10,882,270	78%	3,074,730	22%
4	Investime	2,500,000	-	864,000	1,116,456	1,980,456	79%	519,544	21%
	Totali	71,217,100	18,366,201	18,724,483	23,486,468	60,577,152	85%	10,639,948	15%



Shpenzimet buxhetore të kryera deri më 31.12.2024 zënë 85 % të Plan Buxhetit të parashikuar.

Dy klasat “**Fondi i pagave**” dhe “**Sigurime shoqërore**” të cilat ecin paralelisht me njëra tjetrën nuk janë realizuar sipas parashikimit deri me 31.12.2024 pasi gjatë kësaj periudhe ka pasur disa vende vakante në organikë.

Për fondin e pagave, me gjithë ndryshimet ne legjislacion sipas VKM nr.421 date 26.06.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, të ndryshuar” si dhe VKM nr. 422 date 26.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar”, ku është përcaktuar rritja e pagës për disa

kategori, nuk u kërkuar ndryshime në plan buxhetin e vitit 2024 pranë Këshillin të Ministrave, pasi shtesat do të mbulohen me fondet e mbetura nga mungesa e organikës.

Në klasën "**Shërbime e Furniturë**", gjatë periudhës raportuese deri më 31.12.2024 është realizuar 78% e planit të parashikuar. Zërat të cilat nuk janë realizuar sipas parashikimeve dhe që çojnë në këtë përqindje realizimin e shërbimeve furniturë janë mbetje të zërit pagesa në natyrë dhe bonus transporti që lidhet me vende vakante në organike; zëri udhëtime dhe dieta jashtë pasi disa udhëtime të parashikuara detajuar në Vendimet të KKRR Nr.2, datë 10.01.2024 nuk janë zhvilluar; Nuk ka pasur shpenzime për trajnim gjatë vitit dhe shpenzime për pritje përcjellje. Janë minimizuar shpenzimet për komisione bankare duke hapur një llogari të re pranë BKT me kushte të tjera në lidhje me komisionet brenda dhe jashtë vendit si rrjedhojë ky zë ka vlerë të mbetur. Shpenzimet e parashikuara për telefon mobile janë minimale pasi përfituesit e këtij zëri kanë bërë paketa ofertë dhe nuk kanë shfrytëzuar vlerat e parashikuara sipas ligjit. Nuk ka pasur shërbim mirëmbajtje për pajisje kompjuterike dhe printimi.

Përgjatë vitit 2024 stafi ka marr pjesë në 4 aktivitete jashtë vendit sipas programit të miratuar me Vendimet të KKRR Nr.2, datë 10.01.2024 Nr.20 Prot., datë 10.01.2024, "Për miratimin e programit paraprak vjetor të shërbimeve jashtë vendit të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2024". Detajimi mbi aktivitetet, pjesëmarrjen dhe shpenzimet është paraqitur në aneksin nr.3 Evidencë e realizimit të udhëtimeve dieta jashtë vendit Janar-Dhjetor 2024.

Gjatë vitit ka pasur shumë aktivitete brenda vendit në kuadër të riorganizimit të sektorit në bazë të VKM nr. 302 datë 11.05.2022 "Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", për prezantimin e nivelit të ri tarifor në disa rrethe.

Në 4-mujorin e parë njëri nga aktivitetet ndërkombëtar është zhvilluar në Kosovë, në 4-mujorin e dytë një aktivitet është zhvilluar në Shkup ndërsa në 4-mujorin e tretë nga 2 aktivitete njëri është zhvilluar në Kosovë dhe tjetri në B. Hercegovina ku transporti është organizuar me automjetet e institucionit. Në raport me lëvizjet brenda dhe jashtë vendit janë përshkruar gjithsej 18 738 km dhe është konsumuar 1 712 litra naftë sipas detajimit në Tabelën e mëposhtme:

Tabela 9 Kilometra të përshkruar dhe konsumi i naftës

Përshkrim	Rrugë 4-mujori I në km	Rrugë 4-mujori II në km	Rrugë 4-mujori III në km	Përshkrim	Konsumi i naftës 4- mujori I në litra	Konsumi i naftës 4- mujori II në litra	Konsumi i naftës 4- mujori III në litra
AA293TU	3,230	4,003	4,730	AA293TU	307	365	425
AA834TS	2,843	2,465	1,467	AA834TS	257	223	135
Totali	6,073	6,468	6,197	Totali	564	588	560
18,738				1,712			

Të dhëna analitike të realizimit të shpenzimeve buxhetore gjenden në **Aneksin II "Evidencën e realizimit të shpenzimeve Janar – Gusht 2024"** bashkëlidhur këtij informacioni.

4. INVESTIME

Për sa u përket investimeve, Plani Buxheti i miratuar për këtë klasë është në shumën totale 2 500 000 lekë për tu shfrytëzuar në tre zëra të detajuar në tabelën e mëposhtme.

Në bazë të nevojave të institucionit për të instaluar programe të ndryshme që nuk instalohen në serverin qendror (VPN dhe HRMIS) është parashikuar blerja e disa njësive qendrore dhe ekraneve për personat e autorizuar të cilët kanë akses të detyrueshëm kjo në vlerën 800 000 lekë. Ky zë është realizuar në katër mujorin e tretë në vlerën 780 456 leke ose 98 %.

Për nevojat e departamenteve për më tepër vende për të arkivuar dokumentacionin dhe mundësia me hapësira të mjaftueshme u parashikua blerja e pajisjeve dhe mobiljeve të zyrës në vlerën 800.000 lekë. Ky zë është realizuar në katër mujorin e tretë në vlerën 336 000 leke ose 42 %.

Duke qenë se licencat e instaluar në server janë të vitit 2012 dhe ka vështirësi dhe papërshtatshmëri në instalimin e programeve të reja të cilat janë domosdoshmëri në vijimësinë e punës u parashikuar rinovimi i tyre në vlerën 900 000 lekë. Ky zë është realizuar në katër mujorin e dytë në vlerën 864.000 leke ose 96 %.

Të tre këto zëra të sipërpërmendur janë detajuar në emërtim dhe vlerën përkatëse të parashikuar dhe të realizuar në tabelë.

Tabela nr. 10 Plan investimet dhe realizmi deri me 31.12.2024

në lekë

Investime	Parashikuar	Realizuar	Realizuar %
Ekrane Kompjuteri dhe njesi qendrore	800,000	780,456	98%
Pajisje dhe mobilje zyre	800,000	336,000	42%
Licenca	900,000	864,000	96%
Totali	2,500,000	1,980,456	79%

